


# REPUBLIKA E SHQIPËRISË MINISTRIA E FINANCAVE DREJTORIA E PËRGJITHSHME E DOGANAVE



Tiranë më, 21 1 8-12014

## UDHËZIM

# MBI ZBATIMIN PRAKTIK TË PROÇEDURAVE TË MIRATIMIT DHE FUNKSIONIMIT TË PËRFAQËSUESIT TË DREJTËPËRDREJTË PËR OPERATORËT E AKCIZËS

Me qëllim përcaktimin e saktë të proçedurave dhe të kritereve që zbatohen lidhur me përfaqësimin e drejtëpërdrejtë të operatorëve të akcizës në doganë, pa rënë ndesh me nenin 3 të ligjit nr. 61 / 2012, dt. 24.05.2012 "Për Akcizën në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar dhe nenet 2 deri 10 të VKM nr. 612, dt. 05.09.2012 "Për dispozitat Zbatuese të Ligjit për Akcizat në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, për përfaqësuesin fiskal;

Në zbatim të ligjit nr.61 / 2012, dt. 24.05.2012 "Për Akcizat në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar; VKM nr. 612, dt. 05.09.2012 "Për dispozitat Zbaţuese të ligjit për Akcizat në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, shkronjës (a) të pikës 3.2 të nenit 3 të VKM Nr.205, datë 13.04.1999 "Për dispozitat zbatuese të Kodit Doganor" të ndryshuar, Drejtori i Përgjithshëm i Doganave,

# UDHËZON:

#### I. Përkufizime të përgjithshme:

1. Për qëllime të këtij udhëzimi do të përdoren termat e mëposhtëm:

a) *Përfaqësuesi i drejtëpërdrejtë* – është një prej llojeve të përfaqësimit, përmes të cilit, i përfaqësuari mund të caktojë një person tjetër për të vepruar në emër dhe për llogari të tij nën cilësinë e përfaqësuesit të drejtëpërdrejtë, me qëllim kryerjen e veprimeve dhe përmbushjen e formaliteteve të nevojshme të parashikuara nga ligji dhe VKM për akcizat në marrëdhënie

me Autoritetin Doganor.

- b) I përfaqësuari është çdo depozitues i miratuar, dërgues dhe pritës i rregjistruar, në emër e për llogari të të cilit vepron përfaqësuesi i drejtëpërdrejtë.
- c) Përfaqësues është personi që ka të drejtë për të vepruar vetëm në emër dhe për llogari të të përfaqësuarit, i autorizuar nga ky i fundit dhe i njohur nga Autoriteti Doganor.

II. Proçedurat dhe kriteret që do të zbatohen për miratimin e përfaqësuesit të drejtëpërdrejtë të operatorëve të akcizës.

- Çdo person fizik ose juridik i cili është pajisur me autorizim nga Autoriteti Doganor si depozitues i miratuar, dërgues i rregjistruar apo pritës i rregjistruar mund të caktojë një përfaqësues të tij të drejtëpërdrejtë, për marrëdhëniet me Autoritetin Doganor.
- 2. Garancia për të mbuluar veprimet e lëvizjes apo mbajtjes së produkteve të akcizës me pezullim të detyrimeve do bëhet nga vetë i përfaqësuari sipas përcaktimeve në nenet 3, 21 dhe 22 të ligjit nr.61 / 2012, dt. 24.05.2012 "Për Akcizat në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar; dhe VKM nr. 612, dt. 05.09.2012 "Për dispozitat Zbatuese të ligjit për Akcizat në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar. Gjithashtu, edhe pagesa e akcizës do të bëhet sipas përcaktimeve në nenet 3 pika 2 shkronja b të ligjit nr. 61 / 2012 dhe neneve 15 16 të VKM nr. 612 / 2012.
- 3. Kriteret që duhet të plotësojë personi që do të veprojë si përfaqësues i drejtëpërdrejtë janë:
  - a) Të ketë zotësi juridike dhe zotësi për të vepruar si dhe të jetë person i vendosur në territorin e Republikës së Shqipërisë ;
  - b) Të zotërojë një marrëveshje kontraktuale punësimi me të përfaqësuarin;
  - c) Të zotërojë prokurë përfaqësimi, dokument i cili merr forcë ligjore vetëm nësë është nënshkruar para noterit dhe që duhet të përmbajë: emrin e të përfaqësuarit; kodin fiskal të të përfaqësuarit; detyrat dhe të drejtat e përfaqësuesit që i janë ngarkuar nga i përfaqësuari; afatin e vlefshmërisë së dokumentit; nënshkrimin e të përfaqësuarit.
- 4. Kriteret e përmendura më lart parashtrohen në kërkesën për miratim (njohje) të personit që do të veprojë si përfaqësues i drejtëpërdrejtë. Kësaj kërkese i bashkëngjitet dokumentacioni i nevojshëm që vërteton plotësimin e kritereve.
- 5. Kërkesa për miratimin e përfaqësuesit të drejtëpërdrejtë duhet të hartohet nga personi që kërkon të përfaqësohet (depozitues i miratuar, dërgues i rregjistruar, pritës i rregjistruar) në doganë sipas Aneksit 1, bashkëngjitur. Kjo kërkesë duhet të paraqitet në Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave, në të cilën, përfaqësuesi nënshkruan personalisht në prezencë të punonjësit doganor të ngarkuar me shqyrtimin e kërkesës duke bërë të mundur depozitimin e firmës për njohje dhe krahasimin e saj me nënshkrimin në dokumentin e identifikimit (kartë identiteti).
- 6. Drejtoria e Përgjithshme e Doganave (Drejtoria Teknike në Departamentin e Akcizës) pasi shqyrton dokumentacionin, përgatit për miratim autorizimin sipas Aneksit 2 bashkëngjitur. Pas miratimit të autorizimit të përfaqësimit të drejtëpërdrejtë nga Drejtori i Përgjithshme e Doganave, Drejtoria Teknike kryen rregjistrimin në sistemin Asycuda World të të dhënave që


lidhen me personin që do të veprojë si përfaqësues i drejtëpërdrejtë. Për qëllime të identifikimit, numri i autorizimit me katër (4) shifra dhe me gërmën "T" në fund do të përdoret si kod individual i përfaqësuesit fiskal, për kryerjen në sistem të veprimeve.

### III. Rregulla të përgjithshme

 Në të gjitha rastet, përfaqësuesi i drejtëpërdrejtë, pavarësisht se vepron në emër dhe për llogari të të përfaqësuarit, duhet të:

- a) paraqesë autorizimin që i jep mundësinë të përfaqësojë në mënyrë të drejtëpërdrejtë së bashku me prokurën e përfaqësimit dhe dokumentin e identifikimit (kartë identiteti ose pasaportë).
- b) kryejë të njëjtat proçedura në deklarim si depozituesi i miratuar, dërguesi apo pritësi i regjistruar që ai përfaqëson. Ai është i detyruar të mbajë regjistrime / kontabilitet, forma dhe përmbajtja e të cilave, për çdo mall akcize, si dhe vendi ku duhen mbajtur ato, të disponueshme për administratën doganore, përcaktohen në nenet 53 deri 56 të VKM nr. 612 / 2012.
- 2. Në rastet kur i përfaqësuari vendos të mos përfaqësohet nga përfaqësuesi i drejtëpëdrejtë, për të cilin është lëshuar një autorizim nga Autoriteti Doganor, është i detyruar të njoftojë me shkrim Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave (Drejtorinë Teknike pranë Departamentit të Akcizës) në mënyrë që kjo e fundit të mundësojë bllokimin në sistem të të drejtave të përfaqësuesit.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave.



and the second s

#### ANEKSI 1

# KERKESE PER MIRATIM TE PERFAQESIMIT TE DREJTPERDREJTE PER **OPERATORET E AKCIZES**

Kerkuesi (emri, adresa, NIPT-i/NUIS):

Drejtuar:

 $Z_{i}/Z_{i}$ .

Drejtorise se Pergjithshme te Doganave

Ne cilesine e personit qe kerkon te perfaqesohet per veprimet qe lidhen me plotesimin e formaliteteve te deklarimit te mallrave te akcizes kemi caktuar te perfaqesohemi ne menyre te drejtperdrejte nga:

me leternjoftim nr.\_\_\_\_\_

per deklarim te mallrave me DSHA per:

- Hyrjen e produkteve nga tregu i brendshem ne magazine fiskale; a)
- Hedhjen per konsum te mallrave me detyrime te paguara; **b**)
- Levizjet nga nje magazine fiskale ne nje tjeter; c)
- Levizjet nga nje magazine fiskale te perjashtuesi i miratuar; ç)
- Levizjet nga nje magazine fiskale ne nje regjim doganor exp/ose pezullues; d)
- Levizjet nga nje regjim doganor drejt nje magazine fiskale; dh)
- Pakesim dhe shtesat e konstatuara nga kontrollet dhe inventarizimet. e)

Prane autoriteteve doganore te Zyres Doganore

KERKUESI (nenshkrimi, vula)

Per plotesim nga autoritetet doganore miratuese


Dokumentacioni bashkangjitur:

Prokure e posacme perfaqesimi


Dokument identifikimi (leternjoftim)

Kontrate pune

Depozitimi i nenshkrimit nga personi: Emer, mbiemer, nenshkrim:



Konfirmimi nga punonjesi i DPD: Emer, mbiemer, nenshkrim:



٠

ANEKSI 2



#### REPUBLIKA E SHQIPËRISË

# Ministria e Financave DREJTORIA E PËRGJITHSHME E DOGANAVE

Nr. Prot.

Tiranë, më /2014

# AUTORIZIM Nr.

Në mbështetje të ligjit nr.61 / 2012, dt. 24.05.2012 "Për Akcizat në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, autorizojmë Z./Znj \_\_\_\_\_\_, të kryejë përfaqësimin e drejtpërdrejte për llogari të Shoqërisë "\_\_\_\_\_\_" me NIPT-i/NUIS nr.

#### Elisa SPIROPALI

# DREJTOR I PËRGJITHSHËM

